

Shqipëria i reagon ashpër
Serbisë për pretendimet se
në Kosovë ka "spastrim
etnik të serbëve": I hedhim
poshtë me forcë I FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AKTUALE



**KOORDINATORJA NACIONALE
PËR ZGJEDHJE TAKOHET ME
PËRFAQËSUESET E MISIONIT TË
BE-SË, DISKUTOJNË PËR
MBROJTJEN E VOTËS MË 12 TETOR**

F.7

**KOSOVA DHE SHQIPËRIA
THELLOJNË BASHKËPUNIMIN NË
FUSHËN E DREJTËSISË PENALE**

F.7

**SEKUESTROHEN 40 MIJË EURO
FALSE NË PRISHTINË,
ARRESTOHEN DY PERSONA**

F.6

EKONOMI



**QEVERIA NDAN NGA 100 EURO
PËR STUDENTËT DHE SHITESA
PËR ATA QË UDHËTOJNË**

F.8

**KOSOVARËT PO LËNË PARANË
E GATSHME, MBI 1.6 MILION
KARTELA AKTIVE BANKARE**

F.8

SPORT



**KOSOVA NIS PËRGATITJET PËR
NDESHJET E TETORIT**

F.11

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

**“DIPLOMACI ME KAKOFONI”:
KUSH FLET PËR KOSOVËN?**

F.4-5

**ÇITAKU: VENDI
MUND TË
SHKOJË NË
ZGJEDHJE TË
JASHTËZAKONSHME
NË FUND
TË KËTIJ VITI**

F.5



Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, e ka akuzuar Serbinë për ndërhyrje në zgjedhjet lokale të 12 tetorit duke bërë premtime për vende pune dhe përfitime financiare. Kurti ka

thënë se veprimet e fundit të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, edhe të aktorëve të tjerë serbë, shtetërorë dhe joshetërorë, “nuk mund të cilësohen ndryshe përveçse ndërhyrje në procesin

e zgjedhjeve lokale të tetorit në Kosovë”. Në këtë kontekst, Kurti i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian ta dënojë këtë veprim të Beogradit zyrtar i cili po ndërhyr në zgjedhjet demokratike

thënë se veprimet e fundit të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, edhe të aktorëve të tjerë serbë, shtetërorë dhe joshetërorë, “nuk mund të cilësohen ndryshe përveçse ndërhyrje në procesin

Zelensky: Ukraina do të anëtarësohet në BE pavarësisht qëndrimit të Orbanit



KIEV, 7 TETOR - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka deklaruar se Ukraina do të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian (BE) pavarësisht nga qëndrimi i kryeministrit hungarez,

Viktor Orban. Këtë deklaratë, Zelensky e ka dhënë gjatë një konference për medie me kryeministrin e Holandës, Dick Schoof. Ai ka shprehur besimin se populli hungarez

e mbështet Ukrainën në çdo rast. “Ukraina do të jetë në Bashkimin Evropian, me ose pa Orbanin, sepse kjo është zgjedhja e popullit ukrainas”, ka thënë Zelensky.

Presidenti ukrainas ka komentuar mbi mundësinë e ndryshimit të rregullave të procedurës në mënyrë që të mos kërkohet një vendim unanim për zgjerimin e BE-së.

IZRAELI SHËNON DYVJETORIN E SULMIT TË 7 TETORIT TEKSA PALËT ZHVILLOJNË BISEDIMET PËR T’I DHËNË FUND LUFTËS NË GAZA

JERUSALEM, 7 TETOR - Izraeli ka shënuar përvjetorin e dytë të sulmit të 7 tetorit 2023, ndërkohë që negociatorët izraelitë dhe ata të Hamasit janë duke zhvilluar bisedime të tërthorta për t’i dhënë fund luftës dyvjeçare në Rripin e Gazës në përputhje me një plan për paqe të propozuar nga Shtetet e Bashkuara. Dy vjet më parë, në përfundim të festivalit hebraik Sukkot, militantë të udhëhequr nga Hamasi, grupi palestinez i shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe vende të tjera, e kanë kaluar kufirin midis Gazës dhe Izraelit, duke sulmuar komunitete në jug të Izraelit dhe një festival muzike në shkretëtirë me armë zjarri, raketa dhe granata. Ata i kanë vrarë rreth 1 200 njerëz, kryesisht civilë, sipas autoriteteve izraelite. Militantët i kanë rrëmbyer gjithashtu 251 njerëz dhe çuar në Gaza, nga të cilët 47 mbeten ende robër, përfshirë 25 që ushtria izraelite thotë se janë të vdekur. Të martën në Izrael janë

planifikuar aktivitete përkujtimore për të shënuar përvjetorin e dytë të këtij sulmi. Dhjetëra të afërm dhe miq të viktimave të festivalit muzikor “Nova” kanë ndezur qirinj dhe kanë mbajtur një minutë heshtje në vendin e sulmit në jug të Izraelit, ku militantët vranë më shumë se 370 njerëz dhe morën rrëmbyen dhjetëra të tjerë. Një tjetër ceremoni është zhvilluar në Sheshin e Pengjeve në Tel Aviv, ku izraelitët përmes protestave javore vazhdojnë të kërkojnë lirin e pengjeve. Një ceremoni shtetërore përkujtimore është planifikuar për më 16 tetor, pas përfundimit të festës së Sukkotit. Lufta hakmarrëse e Izraelit në Gaza, nga ajri, toka dhe deti, i ka vrarë të paktën 67 mijë palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në territorin e kontrolluar nga Hamasi. Lagje të tëra janë rrafshuar dhe janë shkatërruar shtëpi, spitale, shkolla dhe ujësjellës. Qindra mijëra banorë të

zhvendosur të Gazës tani strehohen në kampe të mbipopulluara dhe hapësira të hapura, me pak qasje në ushqim, ujë apo kushte higjienike. Pas dy vjetëve luftë, 72 për qind e publikut izraelit ka shprehur pakënaqësi me mënyrën se si qeveria po e menaxhon luftën, sipas një sondazhi të fundit nga Instituti për Studime të Sigurisë Kombëtare. Gjatë kësaj lufte, Izraeli e ka zgjeruar shtrirjen e tij ushtarake, duke goditur shënjestra në pesë vende të rajonit, përfshirë Iranin, dhe duke vrarë disa figura të larta të Hamasit si dhe udhëheqësin e Hezbollahut, Hassan Nasrallah. Izraeli dhe Hamasi përballen tani me trysni të madhe ndërkombëtare për t’i dhënë fund luftës. Një hetim i OKB-së muajin e kaluar gjeti se Izraeli po kryen gjenocid në Gazë, ndërsa grupet për të drejtat e njeriut e akuzojnë Hamasin për krime lufte në sulmin e 7 tetorit. Të dyja palët i



kanë mohuar akuzat. Javën e kaluar, presidenti amerikan Donald Trump, ka paraqitur një plan me 20 pika që kërkon armëpushim, lirin e të gjithë pengjeve, çarmatimin e Hamasit dhe tërheqjen graduale të Izraelit nga Gaza. Bisedimet e tërthorta kanë nisur të hënën në qytetin turistik egjiptian Sharmel-Sheikh, me ndërmjetës që lëviznin mes delegacioneve nën masa të repta sigurie. “Al-Qahera News”, e lidhur me inteligjencën shtetërore egjiptiane,

ka raportuar se diskutimet u përqendruan në “përgatitjen e kushteve fillestare” për një shkëmbim pengjesh dhe të burgosurish. Trumpi u ka bërë thirrje negociatorëve të “lëvizin shpejt” për t’i dhënë fund luftës në Gazë, ku sulmet ajrore izraelite kanë vazhduar edhe të hënën. Megjithëse të dyja palët e kanë mirëpritur propozimin e Trumpit, arritja e një marrëveshjeje për hollësitë e tij pritet të jetë një detyrë tejet e vështirë.

MERZI E AKUZON PUTININ PËR “LUFTË HIBRIDE” NDAJ GJERMANISË

BERLIN, 7 TETOR - Kancelari gjerman Friedrich Merz e ka akuzuar presidentin rus, Vladimir Putin, se është duke zhvilluar një “luftë hibride” ndaj Gjermanisë. “Ai po zhvillon një luftë të informacionit ndaj nesh. Ai po zhvillon një luftë ushtarake kundër Ukrainës dhe kjo luftë është e drejtur ndaj të gjithë nesh”, ka thënë Merz për transmetuesin gjerman, “NTV”. Sipas udhëheqësit gjerman,



presidenti rus është duke dëshiruar që ta përmbyjë rendin politik të Evropës. “Prandaj ne e mbështesim Ukrainën”, ka

shpjeguar Merz, duke shtuar se është në interesin e Gjermanisë që të mbrojnë rendin politik të shoqërive të hapura dhe liberale në Evropë. Kur është pyetur në mënyrë specifike nëse Putini është duke zhvilluar luftë kundër Gjermanisë, Merz është përgjigjur: “Ai po zhvillon një luftë hibride kundër të gjithë neve”. Sa i përket shtimit të incidenteve me dronë në Gjermani dhe në

mbarë Evropën, Merz ka thënë se “e njohim kërcënimin”, duke shtuar se Putini është duke dëshiruar të nxisë frikë. “Ne nuk do të frikësohemi dhe po ashtu do ta mbrojmë veten në mënyrë efektive kundër këtij kërcënimi”, ka thënë Merz. I pyetur nëse është duke e shqyrtuar idenë që të thërras Putinin, Merz ka thënë se patjetër se e ka në mendje një mundësi të tillë. “Mund të them se çdo

përpjekje për të biseduar me të në këtë moment përfundon me sulme edhe më të ashpra ndaj Ukrainës”, ka thënë ai. Gjermania është mbështetësja më e dytë më e madhe në botë, pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) sa i përket ndihmës ushtarake për Ukrainën, që kur Rusia nisi pushtimin e paprovokuar të shtetit fqinj në shkurt të vitit 2022.

OBSH-ja: 15 milionë adoleshentë në botë përdorin cigare elektronike

GENEVE, 7 TETOR - Të paktën 15 milionë adoleshentë të moshës 13 deri në 15 vjeç përdorin cigare elektronike në mbarë botën, sipas raportit të parë global të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Sipas raportit, të rinjtë kanë nëntë herë më shumë gjasa të

përdorin cigare elektronike sesa të rriturit, çka tregon një rritje alarmante të varësisë nga nikotina në këtë grupmoshë. Në total, mbi 100 milionë persona përdorin cigare elektronike në botë, përfshirë të paktën 86 milionë të rritur, kryesisht në vendet me standard të lartë

jetese, raporton “Reuters”. Këto të dhëna publikohen në një kohë kur përdorimi i duhanit tradicional ka rënë ndjeshëm – nga 1.38 miliard përdorues në vitin 2000, në 1.2 miliard në vitin 2024. Përballë rregulloreve më të ashpra kundër duhanit, industria e duhanit po

orientohet drejt produkteve alternative, si cigaret elektronike, për të kompensuar rënien e shitjeve. Kompanitë që prodhojnë këto produkte i paraqesin cigaret elektronike si alternativë më pak të dëmshme dhe si ndihmë për të lënë duhanin, por OBSH-ja ka



paralajmëruar për efektin e kundërt tek të rinjtë.

Thaçit, Smakajt, Kliajt dhe Fazliut u vazhdohet paraburgimi në Speciale

HAGË, 7 TETOR - Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt dhe Fadil Fazliut u është vazhduar paraburgimi nga Gjykata Speciale në Hagë. Vendimi është marrë më 3 tetor nga një gjykatës i procedurës paraprake, mirëpo është riklasifikuar si publik tek të martën. Gjykatësja Marjorie

Masselot ka vlerësuar në vendimin e saj se ekziston dyshimi i bazuar se Thaçi dhe të tjerët kanë kryer veprat penale të shkeljes së fshehtësisë zyrtare dhe pengimit të drejtësisë. Gjithashtu, si argument për vazhdimin e mbajtjes prapa grilave është përdorur edhe e ashtuquajtura “klima

intimiduese kundër dëshmitarëve” në Kosovë. Ish-presidenti Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Hajredin Kuçi, Fadil Fazliu e Isni Kilaj po përballen me akuzat për ndërhyrje dhe pengim të drejtësisë në Hagë. Çështja ndaj tyre është ende në fazën paraprake.



SHQIPËRIA I REAGON ASHPËR SERBISË PËR PRETENDIMET SE NË KOSOVË KA “SPASTRIM ETNIK TË SERBËVE”: I HEDHIM POSHTË ME FORCË

TIRANË, 7 TETOR - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë (MEPJ) i ka reaguar ashpër Ministrisë së Jashtme të Serbisë e cila ka vazhduar pretendimet se në Kosovë po ndodh “spastrim etnik i serbëve”. Kjo ministri ka thënë se i hedh poshtë me forcë e vendosmëri këto pretendime të Serbisë dhe ia ka kujtuar asaj ngjarjet tragjike të vitit 1999 kur kishte ndodhur spastrimi etnik i shqiptarëve të Kosovës.

“Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë shpreh keqardhjen e thellë për deklaratën e Ministrisë së Jashtme të Republikës së Serbisë, të datës 4 tetor 2025, e cila përpiqet të rikthejë hijet e së shkuarës mbi një rajon që po përpiqet të ecë drejt së ardhmes. Në këtë deklaratë ngrihet një seri akuzash dhe pretendimesh të pabaza, të cilat Shqipëria i hedh poshtë me forcë dhe vendosmëri. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë e gjen me vend t’i kujtojë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë disa të vërteta historike, që lidhen me shkaktarët e vërtetë të ngjarjeve tragjike të vitit 1999, ngjarje që sollën vrasje, spastrime etnike dhe dëbimin me forcë të rreth një



million shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre”, është thënë në reagimin e MEPJ-së, e cila drejtohet nga Elisa Spiropali. Ministria shqiptare ka thënë se është për keqardhje që Serbia vazhdon e mbështetet “ende mbi një Raport tashmë të diskredituar

të Dik Martit”. “Është për të ardhur keq që deklarata e Ministrisë së Jashtme të Serbisë mbështetet ende mbi një Raport tashmë të diskredituar të Dik Martit, kur faktet e hetuara nga autoritetet vendase dhe ndërkombëtare kanë dëshmuar

qartë se pretendimet e ngritura aty janë një fabrikim i pastër, pa asnjë provë faktike. Këto të pavërteta, të njohura ndërkombëtarisht si përpjekje për të njollësuar imazhin e Shqipërisë dhe të Kosovës, nuk mund të përdoren më për t’iu shmangur

përgjegjësisë së historisë. Historia nuk rishkruhet me retorikë, ajo mbahet mend me përgjegjësi. Në këtë kontekst, çdo përpjekje për të përmbytur të vërtetën dhe për të ndërruar rolet e viktimës me të agresorit është e papranueshme dhe bie ndesh me çdo frymë të paqes e pajtimit që rajoni ynë kërkon e meriton”, është thënë në reagim.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë ka shprehur bindjen e thellë se “rajoni ynë ka nevojë për pajtim, respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim të sinqertë në frymën e fqinjësisë së mirë, jo për rikthim të gjuha e akuzave e viktimizimit”.

“Vetëm kështu mund të çlirohemi përfundimisht nga hijet e së shkuarës dhe të ndërtojmë së bashku një të ardhme në paqe, siguri dhe prosperitet një Ballkan të bashkuar në familjen tonë evropiane, ku përkasim nga rrënjët dhe aspiratat. Shqipëria ka qenë dhe do të mbetet e gatshme për një bashkëpunim gjithëpërfshirës rajonal, në frymën e miqësisë së mirë, dinjitetit dhe përgjegjësisë ndaj qytetarëve tanë”, është thënë në reagimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.

Osmani pas takimit me ministret belge: Heqja e masave të BE-së duhet të ndodhë sa më shpejt

PRISHTINË, 7 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim ministrin e Drejtësisë së Belgjikës, Annelies Verlinden dhe ministrin e Azilit dhe Migrimit, Anneleen Van Bossuyt. Në takim është diskutuar për marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Belgjikës, për bashkëpunimin në fushën e drejtësisë, sigurisë, sundimit të ligjit, si dhe për procesin e integritetit evropian dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Presidentja Osmani ka shprehur mirënjohjen e thellë për mbështetjen e vazhdueshme të Belgjikës ndaj

Kosovës dhe theksoi se Belgjika mbetet një nga partneret më të besueshme dhe më parimore të Kosovës në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Në këtë kontekst, Osmani ka theksuar rëndësinë e përshpejtitimit të procesit të integritetit evropian të Kosovës, duke nënvizuar se institucionet e vendit janë plotësisht të përkushtuara në zbatimin e reformave që forcojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe llogaridhënien. Ajo ka thënë se qytetarët e Kosovës janë ndër më proevropianët në kontinent dhe se heqja e masave të BE-së duhet të ndodhë sa më shpejt



dhe se do të ishte një hap i drejtë për rimëkëmbjen e besimit dhe avancimin e agjendës evropiane të vendit.

Siç ka bërë me dije Presidenca, në këtë kontekst, në raport me rrugën e Kosovës për integritet në BE, Osmani ka shtruar

nevojën që Belgjika ta marrë rolin udhëheqës për ta shtyrë përpara aplikimin e Kosovës në BE.

Po ashtu, është bërë me dije në takim, se Osmani ka vënë në pah rezultatet e prekshme në fushën e sundimit të ligjit dhe drejtësisë, përfshirë luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, që janë vlerësuar pozitivisht nga partnerët ndërkombëtarë. Sipas presidentes, bashkëpunimi i ngushtë në mes të Kosovës dhe Belgjikës në drejtësi, siguri dhe mbrojtje është model i partneritetit evropian që forcon paqen, stabilitetin dhe perspektivën e përbashkët.



‘DIPLOMACI ME KAKOFONI’: KUSH FLET PËR KOSOVËN?

Politika e jashtme e një shteti është karta kryesore e ndikimit dhe sigurisë. Për Kosovën, kjo kartë është duke u luajtur në kushte të vështira për shkak të sanksioneve nga BE-ja, pasigurisë në marrëdhëniet me ShBA-në dhe sfidave të pazgjidhura në dialogun me Serbinë. Njohësit e diplomacisë kanë vlerësuar se Kosova nuk ka politikë të jashtme të ndërtuar mbi strategji të qartë. Sipas tyre, Kosovës i mungon qartësia në përcaktimin e qëndrimeve në raport me partnerët ndërkombëtarë, veçmas me ShBA-në dhe BE

PRISHTINË, 7 TETOR - Për çdo vend politika e jashtme është karta kryesore e ndikimit dhe sigurisë. Për Kosovën, kjo kartë është duke u luajtur në kushte të vështira: sanksione nga Bashkimi Evropian, pasiguri në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe sfida të pazgjidhura në dialogun me Serbinë. Sikur këto të mos mjaftonin, situata komplikohet edhe më nga mungesa e dukshme e koordinimit mes institucioneve dhe paqartësia në përcaktimin e qëndrimeve para partnerëve ndërkombëtarë. Ish-diplomati Albert Prenkaj ka thënë se Kosova nuk ka një politikë të jashtme të ndërtuar mbi strategji të qartë dhe aleanca të konsoliduara. Sipas tij, vendit i mungojnë konvergjenca, bashkëpunimi dhe sinergia me ShBA-në dhe BE-në. “Kosova është duke përjetuar një asfiksion, një vetëmbyllje dhe ka

humbur relevancën në arenën ndërkombëtare. Ka një mungesë totale koordinimi, një kakofoni në politikën e jashtme, që, për pasojë, ka sjellë sanksione”, ka thënë Prenkaj për programin “Expose” të “Radios Evropa e Lirë”. Për më shumë se dy vjet Kosova është nën sanksione të BE-së për shkak të vendimeve të qeverisë që janë perceptuar si të njëanshme dhe në dëm të komunitetit serb. Së fundmi, edhe ShBA-ja ka pezulluar nisjen e dialogut strategjik me Kosovën - të krijuar për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe - duke shtuar pasigurinë dhe izolimin ndërkombëtar të vendit. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka pranuar ekzistencën e disa dallimeve me ShBA-në, por ka theksuar se Kosova nuk i ka prishur marrëdhëniet me të. Presidentja Vjosa Osmani, në anën tjetër, ka shprehur keqardhje për pezullimin e dialogut

strategjik dhe ka nënvizuar rëndësinë e ruajtjes së lidhjeve të forta me ShBA-në. Në fund të muajit të kaluar, të dy këta udhëheqës dhe shefja në detyrë e diplomacisë kosovare, Donika Gërvalla, kanë qëndruar në Shtetet e Bashkuara, derisa ka zhvilluar punimet Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, por të tre me agenda të ndara prej njëri-tjetrit. Nga takimet e realizuara, Osmani ka publikuar fotografi me presidentin amerikan, Donald Trump dhe me sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio. Gërvalla ka marrë pjesë në një forum të ministre të Jashtme gra dhe ka zhvilluar takime të ndara me homologet nga Shqipëria dhe Andorra, ndërsa Kurti ka shpërndarë pamje nga takimet me kongresistë, me studentë, me shqiptaro-amerikanë e të tjerë. Njoftime për ndonjë takim të Kurtit apo Gërvallës me përfaqësues të Departamentit Amerikan të Shtetit nuk ka pasur. Ngjashëm as për ndonjë takim të përbashkët të udhëheqësve kosovarë me udhëheqës të ShBA-së apo shteteve të tjera. Me Kushtetuten e Kosovës, nenin 84, politika e jashtme është kompetencë e Presidencës. Por, kjo përgjegjësi shpesh ka shkaktuar edhe tensione me qeverinë. Dy udhëheqësit e tanishëm Osmani dhe Kurti janë bashkuar në një listë zgjedhore në vitin 2021, duke premtuar një vizion të përbashkët politik. “Kemi bërë marrëveshjen e parimeve dhe

synimeve politike, të cilën sapo e nënshkruam para jush - marrëveshje kjo për një shtet me drejtësi dhe pa korrupsion, për një shoqëri me shëndet, punësim e arsim për të gjithë qytetarët, pa dallime, diskriminime e favorizime”, ka deklaruar Kurti në janar të vitit 2021. Por, rruga e tyre nuk ka qenë gjithmonë e njëjta. Dallimet janë shfaqur në raportet me aleatët, në debatin për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, për tarifën ndaj mallrave të ShBA-së e për çështje të tjera. Ndonjëherë kanë qenë të hapura, e ndonjëherë më të tërthorta. Për Donika Eminin, nga Grupi Këshillëdhënës në Evropë për Politika të Ballkanit, këto përplasje në politikën e jashtme nuk janë të reja. Ajo ka kujtuar rastin e ish-presidentit Hashim Thaçi dhe ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, kur janë përplasur rreth idesë së ndryshimit të kufijve Kosovë-Serbi në vitin 2018. Sipas saj, qasjet e tilla të pakoordinuara e paraqesin Kosovën si shtet të paqëndrueshëm dhe joserioz në sytë e ndërkombëtarëve. “Për shembull, moskoordinimi i mirëfilltë në kohën kur masat e BE-së janë vënë për Kosovën, sepse ka qenë një periudhë gjashtëmujore prej masave që nuk kanë qenë vendim i Këshillit [të BE-së] e derisa janë bërë... për gjashtë muaj kanë mundur të koordinohen me një diplomaci më të mirëfilltë, në mënyrë që të çoheshin mesazhe të qarta në Bruksel... por të dy, edhe Kurti, edhe Osmani e kanë neglizhuar këtë punë”, ka thënë Emini.

“Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar Zyrës së Presidentes, Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme për të mësuar mbi prioritetet e politikës së jashtme dhe mënyrat e koordinimit mes tyre, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Sipas Prenkajt, fërkimet mes liderëve nuk janë thjesht dallime mendimesh, por një “luftë për dominancë egosh” që e vështirëson ndërtimin e një vizioni të përbashkët. Edhe Emini e ka parë këtë si garë të dëmshme për protagonistin. “Ne funksionojmë me politikë të jashtme, e cila formohet në mënyrë ‘ad hoc’, në baza ditore politike, për konsum të brendshëm dhe jo për kalkulime të jashtme. Domethënë, është agjendë personale politike e personave të caktuar në Kosovë, është kalkulim politik dhe ego”, ka thënë ajo. Prenkaj është i bindur se rruga për rikthimin e Kosovës në skenën ndërkombëtare kalon përmes përmbyshjes së përgjegjësive të marra në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Sipas tij, Kosova duhet të tregojë se është e gatshme t’i zbatojë marrëveshjet. “Në këtë rast bëhet fjalë për (themelimin e) Asociacionit të komunave me shumicë serbe. E, pastaj, mund të kërkojmë heqjen e masave (të BE-së), fillimin e procesit të anëtarësimit në Këshillin e Evropës, njohjen në pako të pesë vendeve të BE-së, e kështu me radhë”, thotë ish-ambasadori i Kosovës në Itali.

KURTI E AKUZON SERBINË PËR NDËRHYRJE NË ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË, KËRKON REAGIMIN E BE-së

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, e ka akuzuar Serbinë për ndërhyrje në zgjedhjet lokale të 12 tetorit duke bërë premtime për vende pune dhe përfitime financiare. Kurti ka thënë se veprimet e fundit të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, edhe të aktorëve të tjerë serbë, shtetërorë dhe joshetërorë, “nuk mund të cilësohen ndryshe përveçse ndërhyrje në procesin e zgjedhjeve lokale të tetorit në Kosovë”. Në këtë kontekst, Kurti i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian ta dënojë këtë veprim të Beogradit zyrtar i cili po ndërhyr në zgjedhjet demokratike

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 7 TETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i ka reaguuar presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka premtuar 400 vende pune për serbët në Kosovë, duke thënë se kjo është ndërhyrje në zgjedhjet e 12 tetorit. Kurti ka thënë se kjo ndërhyrje e Serbisë është edhe më e rëndë sesa ajo e Rusisë në Evropë. “Nuk kanë si të cilësohen ndryshe përveç ndërhyrje në procesin zgjedhor komunal të tetorit në Republikën e Kosovës. Premtimet për vende pune, joshja përmes përfitimit të mbështetjes financiare, kushtëzimi dhe shantazhi me beneficione sociale dhe

deklarimet e zyrtarëve shtetërorë të Serbisë, se vetëm Lista Serbe e mbron Serbinë në Kosovë, siç bëri së fundmi ish-kryeministri i Serbisë, tash këshilltar i presidentit atje, siç ka bërë edhe vetë presidentit Vuçiq, janë metoda të përsëritura të ndërhyrjes së Serbisë në procesin zgjedhor në Kosovë”, ka thënë Kurti të martën në mbledhjen e qeverisë.

Në këtë kontekst, Kurti i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian ta dënojë këtë veprim të Beogradit zyrtar i cili po ndërhyr në zgjedhjet demokratike. “Misioni për vëzhgim i zgjedhjeve i BE-së, në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, kishte evidentuar ndërhyrjen e Serbisë në zgjedhjet tona, se ndërhyrjet



në zgjedhjet e shteteve të tjera janë forma të cenimit të demokracisë dhe sovranitetit të një shteti. Serbia nuk ka pasur asnjë pasojë nga BE-ja, andaj Serbia nuk po ndryshon sjellje. Kjo ndërhyrje që bën Serbia tani në zgjedhjet në Kosovë është më e rëndë se ajo e Rusisë në Evropë. I bëjmë thirrje BE-së ta dënojë ndërhyrjen e Beogradit zyrtar në zgjedhjet në Kosovë dhe ta sanksionojë Serbinë për veprimet që bien ndesh me parimet e fqinjësisë së mirë”, ka deklaruar Kurti. Serbia ishte akuzuar edhe për ndërhyrje në zgjedhjet e

përgjithshme të shkurtit, dhe misioni vëzhgues i BE-së asokohe kishte thënë se Beogradi zyrtar kishte ndërhyrë në zgjedhje përmes trysnisë ndaj votuesve serbë në Kosovë. Serbia ishte akuzuar edhe nga Gjermania për ndërhyrje në zgjedhjet e 9 shkurtit në Kosovë. Ndërkohë, në zgjedhjet lokale të fundjavës, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, e cila gëzon mbështetjen e Serbisë, Lista Serbe, pritet ta rimarrë pushtetin në komunat me shumicë serbe në Kosovë. Katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës,

Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, udhëhiqen nga kryetarë shqiptarë, pasi në nëntor të vitit 2022 të gjithë përfaqësuesit e Listës Serbe dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës si reagim ndaj vendimit të autoriteteve të Kosovës për t'i hequr targat serbe të makinave. Serbët, duke ndjekur udhëzimet e Listës Serbe, nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme në këto komuna më 2023, si dhe kanë bojkotuar edhe votimin për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në prill të vitit 2024. Por, Lista Serbe do të garojë sërish të dielën për ta kthyer pushtetin në veri në një kohë tensionesh për shkak të përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për ta vendosur kontrollin atje.

Banorët serbë të komunave veriore të Kosovës janë të ndarë mes shpresës dhe skepticizmit për zgjedhjet e 12 tetorit, pasi disa e presin rikthimin e serbëve në krye të komunave si “liri”, ndërsa të tjerët nuk presin ndryshime të mëdha. Serbia, e cila vazhdon ta kundërshtojë pavarësinë e Kosovës duke e cilësuar atë pjesë të vetën, ka ndarë të ardhura nga buxheti shtetëror për pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë. Kjo përfshin paga, pensione, shtesa për fëmijë dhe ndihma të tjera financiare.

Çitaku: Vendi mund të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme në fund të këtij viti

PRISHTINË, 7 TETOR - Nënkrjetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Vlera Çitaku, ka dhënë sinjale se vendi mund të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme në fund të këtij viti për shkak të, siç ka thënë, të kryeneçësisë të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, për formimin e institucioneve të reja, Kuvendit dhe qeverisë.

Çitaku ka thënë se për këtë janë duke punuar intensivisht në terren me synim që të kthehet normaliteti në Kosovë. “Është e

dhimbshme që tani e shtatë-tetë muaj që Kosova është pa institucione. Në këtë pikë kemi mbërritur për shkak të kryeneçësisë dhe papërgjegjësisë edhe politike por edhe qytetare të zotit Kurti. Kjo situatë të cilën e kemi është për shkak të sjelljes së papërgjegjshme të tij. Kemi kaluar muaj të tërë në përpjekje për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit, ndërkohë që zoti Kurti me vetëdije të plotë e shkelte Kushtetutën. Sikur bota të ishte mbarë nuk do të kishte



nevojë të kishte zgjedhje, mirëpo tani duket që zgjedhjet e reja parlamentare në fund të këtij viti janë të pamangshme. Zoti Kurti nuk

e ka shumicën parlamentare. Gjashtë muaj kanë thënë se kanë, tani po thonë se nuk e kanë. Po sillen me institucionet dhe me fatin e Republikës sikur fëmijët me një lodër. Ne shpresojmë dhe jemi duke punuar vazhdimisht në terren që pas zgjedhjeve të reja parlamentare peizazhi politik në Kosovë të ndryshojë. Të krijohet një shumicë e re parlamentare pa IV-në dhe vendit t'i jepen institucione stabile që, para së gjithash, synojnë ta kthejnë normalitetin

në vend”, ka thënë Çitaku për “RTV21”.

Ajo e ka përjashtuar kategorikisht çdo bashkëpunim me IV-në edhe nëse bëhet fjalë për kompromise sa i përket postit të presidentit. “Pas përfundimit të zgjedhjeve të kaluara parlamentare, kandidati ynë për kryeministër e ka bërë të qartë se dallimet politike dhe ideologjike në mes të PDK-së dhe IV-së dhe mënyrës se si e shohim Kosovën janë shumë të ndryshme”, ka thënë Çitaku.

Prekaj nënvizon se politika e jashtme duhet të përfaqësojë interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës - përfshirë komunitetin serb. Çdo qasje konfliktuale ndaj këtij komuniteti vetëm se do ta thellonte izolimin e vendit, sipas tij.

Kosova ka nënshkruar një marrëveshje me Serbinë për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe që në vitin 2013, por asnjë qeveri deri më sot nuk e ka zbatuar, nga frika se mund të cenojë funksionalitetin e shtetit.

Trysnia nga BE-ja dhe ShBA-ja ka qenë e vazhdueshme, ndonëse kohët e fundit është zbehur, si

pasojë e krizave ndërkombëtare dhe faktit se Kosova funksionon me Qeveri në detyrë që pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Sipas Eminit, Kosova ka bërë një lëshim të rëndë duke mos ndërtuar asnjë kanal të qëndrueshëm komunikimi me Qeverinë e kancelarit gjerman, Friedrich Merz, marrë parasysh rolin kyç që ka Berlina brenda BE-së. Kjo, sipas saj, i ka kufizuar dukshëm mundësitë e vendit për të avancuar në agjendën evropiane.

Mungesa e strategjisë vërehet, po ashtu, edhe në Uashington. Që nga viti i kaluar, Kosova nuk ka asnjë kontratë lobimi aktive në

Shtetet e Bashkuara. Në faqen zyrtare të Aktit të Regjistrimit të Agjentëve të Huaj të Departamentit amerikan të Drejtësisë nuk figuron asnjë marrëveshje e tillë aktive, për dallim prej Serbisë për shembull, e cila i ka gjashtë kontrata aktive lobimi - një avantazh i dukshëm në garën diplomatike. Për të ilustruar se si duhet të funksionojë një shtet i vogël dhe i kufizuar në arenën ndërkombëtare, Emini sjell shembullin e Tajvanit. Ky vend, megjithëse i pambështetur nga shumë shtete dhe jashtë organizatave të rëndësishme ndërkombëtare për shkak të

presionit të Kinës, ka arritur të ndërtojë një politikë të jashtme koherente, falë demokracisë funksionale dhe koordinimit të ngushtë me partnerët strategjikë. Edhe Prekaj ka kujtuar se shtetet nuk maten me retorikë, por me elemente të prekshme të forcës dhe kapacitetit. “Me Traktatin e Vestfalisë, që është baza e diplomacisë dhe e së drejtës ndërkombëtare, shtetet janë përcaktuar në bazë të katër prerogativave: territori, demografia, siguria dhe ekonomia. Kosova i ka të gjitha këto, por në masë të vogël krahasuar me vendet e tjera; ndaj, konform këtyre prerogativave,

duhet ta marrë rolin e saj në politikën e jashtme dhe në arenën ndërkombëtare”, ka thënë Prekaj.

Kështu, të dy ekspertët bien dakord se Kosovës i duhet një politikë e jashtme që i tejkalon rivalitetet e brendshme dhe e vendos interesin shtetëror mbi egot personale.

Me fjalët e Eminit, Kosova duhet të nisë t'i rregullojë gabimet e veta dhe të bëjë çmos për heqjen e masave ndëshkuese të BE-së, që kanë bllokuar miliona euro dhe takime të rëndësishme. Sipas saj, nuk ka më mbrojtës që ta mbajnë Kosovën mbi supe - çdo energji e huaj ka mbaruar.

MASHTI, KOORDINATORËVE: VERIFIKONI APLIKIMET PËR TEKSTE SHKOLLORE DERI MË 10 TETOR



PRISHTINË, 7 TETOR - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) i ka njoftuar të gjithë koordinatorët e shkollave, se platforma për verifikimin e aplikimeve për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore në e-Kosova do të qëndrojë e hapur deri të premten e 10 tetorit në orën 23:59. Në njoftim e kësaj ministrie është thënë se koordinatorët që ende nuk kanë përfunduar verifikimin e aplikimeve të tyre ftohen që ta bëjnë këtë brenda afatit të përcaktuar në mënyrë që të mundësohet përmbyllja e procesit në kohë. “Aktualisht, sipas të dhënave zyrtare, janë edhe 2 789 aplikime në pritje që duhet të shqyrtohen nga koordinatorët

shkollorë”, ka njoftuar MASHTI. Në rast të vështirësive teknike gjatë procesit të verifikimit, kjo ministri ka bërë me dije se mund të kontaktohet për ndihmë në emailin: libri@rks-gov.net, si dhe në numrat e telefonit: +383 (0) 38 200 65 058 dhe +383 45 834 248. Sipas të dhënave të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI), që nga hapja e platformës më 15 gusht 2025 e deri në mbyllje më 3 tetor 2025, janë pranuar gjithsej 204 283 aplikime, prej të cilave 201 494 janë trajtuar, 196 57 janë aprovuar dhe 5 437 janë refuzuar. MASHTI ka falënderuar të gjithë koordinatorët për angazhimin e tyre dhe bën thirrje që verifikimi i aplikimeve të përfundojë brenda afatit të përcaktuar.

SEKUESTROHEN 40 MIJË EURO FALSE NË PRISHTINË, ARRESTOHEN DY PERSONA

PRISHTINË, 7 TETOR - Dy persona janë arrestuar të martën mbrëma në Prishtinë nën dyshimin për përfshirje në veprën penale të “Falsifikimit të parasë”. Arrestimi është bërë me urdhër të Prokurorisë Speciale të Kosovës pas një operacioni të organizuar nga hetuesit e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në bashkëpunim me Njësinë e Reagimit të Shpejtë të Policisë së Kosovës. Të dyshuarit, me inicialet S. T. dhe A. Th., janë ndaluar në një veturë gjatë operacionit policor ku, pas kontrollit, janë gjetur dhe sekuestruar 40 mijë euro të falsifikuara. Sipas testimeve fillestare, paratë rezultuan të jenë false. Operacioni është zhvilluar pas hetimeve disamujore dhe në bazë të urdhrat të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Pas ndalimit të të



dyshuarve, policia ka kryer kontrole edhe në dy lokacione të tjera: në shtëpitë dhe objektet

përcjellëse të banimit të tyre. Prokuroria Speciale ka njoftuar se në bashkëpunim me Policinë

e Kosovës po ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në përputhje me

dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Hetimet rreth këtij rasti janë në vazhdim.

Tentativë për shmangie doganore, kapet kolagjen në Vërmicë

PRISHTINË, 7 TETOR - Në pikën kufitare të Vërmicës, pas kontroleve të rregullta doganore, është identifikuar një rast i tentativës për shmangie të obligimeve doganore. Dogana e Kosovës ka njoftuar se pas deklarimit të palës se nuk kishte mallra për të deklaruar, gjatë kontrollit zyrtarët e saj kanë hasur në 153 pako me pluhur

kolagjeni (nga 200 gram secila), të cilat ishin të vendosura në bagazh dhe për të cilat pala nuk kishte paraqitur asnjë faturë apo dokumentacion përcjellës. “Malli është ndaluar përkohësisht deri në përfundimin e procedurave të mëtejshme, ndërsa ndaj palës është iniciuar procedurë për kundërvajtje

doganore në bazë të nenit 244 të Kodit Doganor dhe të akcizës së Kosovës. Dogana e Kosovës vazhdon angazhimin e saj për ta ndaluar kontrabandën, për ta mbrojtur ekonominë e vendit dhe për të siguruar që mallrat që hyjnë në Kosovë të jenë të kontrolluara dhe të deklaruar sipas ligjit”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.



OSMANI DHE KURTI NDEROHEN NGA UP-ja ME ÇMIMIN “ALUMNI I NDERIT”

PRISHTINË, 7 TETOR - Universiteti i Prishtinës (UP) ka nderuar me çmimin “Alumni Nderi i UP-së”, presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. Rektori i UP-së, Arben Hajrullahu, ka thënë se ky universitet ka qenë shtëpi e shumë njerëzve të kryengritur idealistë që kanë arritur të kontribuojnë për zhvillimin e këtij vendi. “Ju të diplomuarit e UP-së në përpjekjet e juaja të përditshme të një shteti të së drejtës dhe një Kosove më të zhvilluar dhe më të fortë, e bëni fort krenare edhe shtëpinë tonë të përbashkët, UP-në. Me këtë rast kam nderin e veçantë që në emër të UP-së, respektivisht Shoqatës së të Diplomuarve të UP-së, t’ju dorëzoj çmimin ‘Alumni Nderi i UP-së’”, ka thënë Hajrullahu. Ndërsa presidentja Osmani ka thënë se investimi në dije është



investimi më fisnik që mund të bëjë një shtet. “Të rikthehesh këtu në UP, jo më si studente apo ligjëruese, por për të pranuar një nder nga ky tempull i dijes që të rriti, është një emocion i vërtetë. Këto dy fate, ai i studentes dhe ligjëruese, janë rrugë që më kanë frymëzuar si njeri, profesioniste dhe si presidente. Investimi në dije është

investimi më fisnik që mund të bëjë një shtet, njëkohësisht është edhe investimi më i mençur. Çmimi është një nder i jashtëzakonshëm, është një falënderim për të gjithë profesorët e mi që na mundësuan që të mos dorëzohemi”, ka thënë Osmani. Ndërsa kryeministri në detyrë, Albin Kurti, teksa ka marrë çmimin, ka thënë se qeveria do



t’u përgjigjet të gjitha kërkesave që vijnë nga universiteti. “E shoh veten si njeri i afërt dhe i lidhur me të shkuarën dhe të ardhmen e këtij universiteti. Që nga themelimi i universitetit nuk ka ngjarje që Kosova ta ketë zanafillën në përmbajtjen e vet emrit të studentit. Universiteti u themelua që të ketë kornizë profesionale dhe bartës të

guximit. Ai shërbeu si mënyra më e lartë ndaj protestës dhe okupimit dhe duke treguar se kur dija bëhet ndërgjegje, është gjithmonë akt lirie. UP-ja është një ndër ngjarjet më të mëdha të historisë së Kosovës. Qeveria e Kosovës do t’u përgjigjet të gjitha kërkesave që vijnë nga universiteti. Pranimi i këtij çmimi është një përgjegjësi e madhe”, ka thënë Kurti.

KOORDINATORJA NACIONALE PËR ZGJEDHJE TAKOHET ME PËRFAQËSUESET E MISIONIT TË BE-së, DISKUTOJNË PËR MBROJTJEN E VOTËS MË 12 TETOR



PRISHTINË, 7 TETOR - Përfaqësueset e Misionit të Ekspertëve të Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian (EEM), kryesuar nga analistja ligjore e këtij misioni, Eirini Skouzou, kanë vizituar të martën Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ku janë pritur në takim nga koordinatorja nacionale për zgjedhje, prokurorja Laura Pula. Gjatë këtij takimi është diskutuar për rrjedhën e procesit zgjedhor për zgjedhjet lokale në vendin tonë, që do të mbahen më 12 tetor, me theks të veçantë për planin operativ të prokurorit të shtetit në ditën e zgjedhjeve. Koordinatorja nacionale për zgjedhje, Laura Pula, i ka informuar të pranishmit për angazhimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të

Republikës së Kosovës për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 12 tetor 2025. Po gjatë këtij takimi është diskutuar për koordinimin në mes të prokurorive dhe koordinatores nacionale lidhur me të gjitha aktivitetet e prokurorit të shtetit që do të ndërmerren në rast se do të ketë cenim të procesit zgjedhor, si dhe duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërinstitucional në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit për procesin zgjedhor, në mes të institucioneve që merren me administrimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e rasteve zgjedhore. Ndërsa përfaqësueset e Misionit të Ekspertëve të Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian (EEM) e kanë informuar koordinatoren nacionale të zgjedhjeve për angazhimin dhe për rolin e tyre në procesin zgjedhor.

Kosova dhe Shqipëria thellojnë bashkëpunimin në fushën e drejtësisë penale

PRISHTINË, 7 TETOR - Në kuadër të Forumit të Katërt të Kryeprokurorëve të Përgjithshëm të Ballkanit që po mbahet në Sofje, Bullgari, ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, së bashku me prokurorin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe drejtorin e përgjithshëm të sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Sami Istrefi, kanë zhvilluar një

takim me prokurorin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Olsian Çela, drejtuesin e Prokurorisë së Tiranës, Arens Çela, si dhe drejtuesin e Prokurorisë së Vlorës, Erjon Shqarri. Gjatë këtij takimi është riafirmuar angazhimi i përbashkët institucional në funksion të forcimit të sundimit të ligjit në të dyja shtetet. Palët janë pajtuar se forcimi i bashkëpunimit ndërmjet dy

prokurorive në fushën e drejtësisë penale është thelbësor për përbashkëtimin e sfidave të përbashkëta dhe trajtimin e çështjeve me interes të ndërsjellë. Në fund të takimit u. d. kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, e ka ftuar për vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës prokurorin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Olsian Çela, e cila vizitë do të realizohet së shpejti.



Qeveria në detyrë subvencionon faturat e energjisë

PRISHTINË, 7 TETOR - Edhe këtë vit Qeveria e Kosovës do të bëjë subvencionimin e faturave të energjisë elektrike, ka thënë ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, në një konferencë për medie, pas

mbledhjes së kabinetit qeveritar. “Siç e dini, parvjet ka qenë pilotimi i programit. Vitin e kaluar ka qenë zbatimi i rregullt i programit për subvencionimin e faturave të energjisë elektrike për familjet e cenueshme, ku

kanë qenë mbi 80 mijë familje përfituese. Edhe këtë vit do të vazhdojë programi i njëjtë”, ka thënë Murati. Sipas Muratit, subvencionimi do të fillojë në muajin tetor dhe do të zgjasë deri në mars të 2026-s. “Siç e dini

ose siç mund ta dini prej zbatimit të mëhershëm, programi zbatohet për muajt e stinës së dimrit. Pra fillon në muajin tetor dhe mbaron në muajin mars, kështu që të mbulohet apo koncentrimi i subvencionimi

të bëhet në muajt kur edhe shpenzimi i faturave të energjisë elektrike mund të jetë më i lartë, në mënyrë që të ketë mbulueshmëri dhe të ketë lehtësi sa më të madhe për familjet”, ka thënë Murati.

KOSOVARËT PO LËNË PARANË E GATSHME, MBI 1.6 MILION KARTELA AKTIVE BANKARE

PRISHTINË, 7 TETOR - Përdorimi i kartelave bankare në Kosovë po rritet me ritme të shpejta, duke dëshmuar një transformim të dukshëm të mënyrës së pagesës së qytetarëve, nga paraja e gatshme drejt pagesave digjitale. Një raport i fundit i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vitin 2024 tregon se Kosova po hyn në një fazë të re të modernizimit financiar, me rritje të dukshme të numrit të terminaleve bankare, kartelave të pagesave dhe transaksioneve elektronike.

Kosova me mbi 1.6 milion kartela aktive

Sipas raportit, në fund të vitit 2024 në Kosovë janë regjistruar gjithsej 1 milion e 684 mijë e 34 kartela bankare, përfshirë kartelat e debitit, kreditit dhe ato me para elektronike. Kjo paraqet një rritje prej 4.49-përqindësh krahasuar me vitin 2023. Nga to, 1.4 milion euro janë kartela debiti dhe rreth 195 mijë kartela krediti, ndërsa 75 mijë të tjera janë kartela të institucioneve financiare jobankare me funksion të parasë elektronike. Përbërja

tregon dominimin e “Visa”-s dhe “Mastercard”-it, që përbëjnë afër 98 për qind të tregut, ndërsa kartelat lokale mbeten vetëm në rreth 2 për qind. Pothuajse 77 për qind e kartelave janë contactless, që do të thotë se pagesat kryhen pa kontakt fizik me terminalin, vetëm duke e afëruar kartelën - një teknologji që po bëhet standard në gjithë sektorin bankar të Kosovës.

Rrjeti i terminaleve bankare: 635 ATM dhe mbi 20 mijë POS

Në fund të vitit 2024 në vend janë regjistruar gjithsej 635 bankomate (ATM) dhe 20 913 terminale POS (PointofSale). Numri i terminaleve për pagesa në pika tregtare është rritur 21.7 për qind brenda vitit, duke arritur nivelin më të lartë historik. Krahasuar me dy vitet paraprake, rritja është e qëndrueshme: nga 14 769 POS në vitin 2022, në 20 913 në 2024. Për çdo 1 milion banorë, Kosova ka 13 236 terminale POS dhe 401.9 ATM, ndërsa për çdo 100 kilometra katrorë raportohen 192 terminale POS



dhe 6 ATM. Pjesa më e madhe e terminaleve është përqendruar në Prishtinë për shkak të numrit më të madh të banorëve, filialeve bankare dhe bizneseve që operojnë në kryeqytet. Në qytete të tjera, si Prizren, Ferizaj, Gjilan, Pejë e Gjakovë, rrjeti është më i kufizuar, por në rritje të vazhdueshme.

Pagesat digjitale, zakoni i gjeneratës së re

Të dhënat e BQK-së tregojnë se meshkujt dominojnë në posedimin e kartelave, por hende ku gjinor po zvogëlohet, sidomos te grupmoshat e reja. Grupi më aktiv financiarisht

mbetet ai 26-35 vjeç, që përfaqëson pjesën më të madhe të transaksioneve me debit dhe kredit-kartela si dhe të blerjeve online. Kjo moshë përfshin qytetarët që kanë të ardhura të rregullta dhe janë më të prirë për përdorim të teknologjisë bankare.

Rritje e fortë e pagesave me kartela

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 39.4 milionë transaksione me debit kartela, me një rritje prej 6.5-përqindësh krahasuar me vitin 2023. Edhe pagesat me kredit-kartela janë shtuar, duke arritur 1.37 milion transaksione, ndërsa vlera e

këtyre pagesave vazhdon të jetë dukshëm më e lartë për meshkujt (74 për qind) sesa për femrat (26 për qind). Në aspektin e pagesave online, qytetarët e Kosovës kanë realizuar 5.8 milionë blerje përmes internetit, me vlerë totale prej 296 milionë eurosh, pothuajse dyfishi i vitit paraprak.

Shmangia e parasë së gatshme

Sipas BQK-së, zgjerimi i rrjetit të POS terminaleve, përdorimi i kartelave contactless dhe përhapja e pagesave online po ndikojnë në reduktimin gradual të përdorimit të parasë fizike në qarkullim. Bankat kanë rritur edhe limitin e pagesave pa kontakt deri në 50 euro, duke lehtësuar blerjet e shpejta dhe duke rritur sigurinë për klientët. Edhe pse numri i terminaleve dhe kartelave për banor mbetet më i ulët se në vendet e BE-së, ritmet e rritjes tregojnë për një transformim të qëndrueshëm dhe kulturë të re të konsumit financiar.

QEVERIA NDAN NGA 100 EURO PËR STUDENTËT DHE SHTESA PËR ATA QË UDHËTOJNË

PRISHTINË, 7 TETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për ndarjen e bursave të mobilitetit për studentët e nivelit bachelor që do ta kapin vlerën prej 20 milionë eurosh për një vit. Po ashtu, kabineti qeveritar, vetëm disa ditë nga mbajtja e zgjedhjeve lokale, ka miratuar edhe vendimin për ndarjen e shumës prej 100 eurosh për çdo student që plotëson kriteret për përfitim.



Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se kjo mbështetje nuk mbaron me kaq. “Nga 100 euro shumë e menjëhershme për të gjithë studentët. Mbështetja për

studentët nuk mbaron me kaq. Sot do të merret vendimi edhe për bursën e mobilitetit për studentët ‘bachelor’, ndërsa shuma e mbështetjes do të varet nga distanca e vendbanimit”, ka thënë Kurti të martën në mbledhjen e qeverisë.

Ndërsa ministri në detyrë i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se kjo masë do të ketë një kosto buxhetore prej

rreth 6 milionë eurosh. “Kemi të bëjmë me ndarjen për shumën e menjëhershme për studentët që plotësojnë kriteret në vlerë prej 100 eurosh. Kjo masë parasheh që të ketë kosto prej rreth 6 milionë eurove”, ka thënë Murati.

Ndaj këtij vendimi në kohë fushate ka reaguar anëtar i kryesisë së PDK-së, Arben Mustafa. Ai ka thënë se ky vendim është rikthim i

praktikës për t’u hedhur hi syve të qytetarëve. Mustafa ka thënë se studentët e Kosovës nuk mashtrohen me vendime të tilla. Edhe deputetja e LDK-së ka reaguar ndaj këtij vendimi, duke kërkuar nga prokuroria të veprojë. “Prokuroria është vonuar t’i nxjerrë nga zyra këta uzurpatorë që blejnë vota me taksat e qytetarëve. Kjo është një skemë e korrupsionit publik”, ka deklaruar Bajrami.

Ankandi i radhës i letrave me vlerë mbahet më 13 tetor 2025

PRISHTINË, 7 TETOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 13 tetor 2025 do të mbahet ankandi i njëmbëdhjetë për vitin 2025. Në këtë ankand do të emetohen

obligacione me maturitet pesëvjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe garantitë

shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (pesë vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për hollësi rreth pjesëmarrjes në

ankande për blerjen e letrave me vlerë, MFPT-ja ka kërkuar nga të interesuarit ta kontaktojnë ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës.



HISTORIA E VËRTETË E ED GEINIT, KEQBËRËSIT TË “PËRBINDËSHIT” TË NETFLIX-it

Mund të mos e njihni menjëherë emrin, por me siguri do t’i njihni krimet. Ed Gein ishte një vrasës serik dhe grabitës varresh në vitet ‘50 të shekullit XX, i cili përcaktoi modelin për filmat horror të shekullit XX. Në një tjetër përshtatje për ekran të historisë së tij jashtëzakonisht të tmerrshme - që pritet të dalë këtë herë në Netflix, si pjesë e antologjisë

Përbindëshi [Monster] nga Ryan Murphy - është gjithçka që duhet të dini për “Kasapin e Plainfildit”.

Edward Gein - shqiptohet në rimë me ligësi [mean] - ishte fermer nga Peinfildi, në Uiskonsin, kur doli në faqet e para të gazetave në vitin 1957, pasi trupi pa kokë i 58-vjeçarës Bernice Worden u gjet i varur nga thembrat në një ndërtesë të vogël në pronën e tij.

Kur autoritetet kontrolluan pronën e tij, ata zbuluan një shtëpi tmerresh që do të çonte në etiketimin e Geinit si “vrasësi më grotesk nekrofil në historinë e ShBA-së” dhe më vonë si “Martha Stewarti i vrasësve serikë” (duke iu referuar mbretëreshës amerikane të punimeve në shtëpi).

Dhjetë kafka njerëzore u gjetën në shtëpinë e tij, disa të fshehura në kuti, të tjerat në skajet e shtratit të tij. U gjet gjithashtu një rrip i bërë me thithka, maska të përpunuara nga fytyrat njerëzore, dhe një kostum, një korse dhe geta të prodhuara nga lëkura e grave (Gein pranoi se i vishte para se të kërcente në fermën e tij në dritën e hënës). Ai gjithashtu kishte bërë tasa nga kafkat njerëzore dhe kishte përdorur lëkurën e njeriut për të mbuluar disa karrige, si dhe kishte bërë një abazhur dhe një kosh për letër.

Koka e Wordenit ishte ruajtur në një thes dhe pasi zemra e saj u gjet pranë sobës së kuzhinës, prokurori i qarkut, Earl Kileen, tha: “Duket të jetë një rast kanibalizmi”. Vrasësi u përshkrua në një raport të kohës si “beqar 51-vjeçar me sy të lodhur dhe supe të rëna”. Më vonë u zbulua se Gein, i rritur nga një baba i dhunshëm dhe një nënë kontrolluese, u shpërbë pas vdekjes së nënës së tij, dhe ai ishte një vetmitar që kënaqej duke lexuar revista të dhunshme dhe duke zhvarrosur kufoma nga varrezat lokale. Megjithatë, konsiderohej aq i padëmshëm nga vendasit, saqë e punësonin si dado.

Çfarë ndodhi me të?

Gein përfundimisht pranoi se kishte vrrarë dy gra - Wordenin në vitin 1957 dhe Mary Hoganin, pronaren e një taverne, në vitin

1954. Policia arriti në përfundimin se ai kërkonte viktima që i ngjanin nënës së tij të ndjerë, me të cilën ishte i fiksuar dhe “ndjente se kishte fuqinë ta ringjallte”. Ai u diagnostikua me skizofreni kronike dhe nuk u konsiderua i aftë për të dalë në gjyq deri në vitin 1968. U shpall fajtor vetëm për vrasjen e Wordenit, megjithëse dyshohej për vrasjen e shtatë të tjerëve dhe kishte pranuar se kishte grabitur rreth një duzinë varre të tjera, kryesisht të grave të moshës së mesme.

James Buddy Day ishte regjisor i serialit dokumentar televiziv të vitit 2023, Psiko: Kasetat e zhdukura të Ed Geinit [Psycho: The Lost Tapes of Ed Gein], i cili shfaq audio-incizime të sapozbuluara, ku Gein dëgjohej duke folur me autoritetet natën kur u arrestua. Day tha: “Mund të dëgjosh që është një fermer i thjeshtë, i butë dhe i qetë nga Miduesti, i cili e kupton se është përbindësh, por nuk kupton pse apo si u bë i tillë, dhe pothuajse bashkëpunon me autoritetet për të marrë njëfarë kuptimi për veten”.

Gein e kaloi pjesën tjetër të jetës në një spital psikiatrik, ku vdiq në vitin 1984, në moshën 77-vjeçare.

Lindja e makthit amerikan

Rasti i Geinit do të shndërrohej në model për disa nga horrorët më të paharrueshëm të kinemasë. Los Angeles Times e vlerëson numrin e filmave të bazuar në historinë e tij në 40, duke thënë: “Në mënyrën e tij të çuditshme, fermeri i ndjerë nga Uiskonsini, Ed Gein, ka frymëzuar ndoshta më shumë filma të paharrueshëm të Holivudit sesa Zhan D’Arka apo Billi Kidi [Billy the Kid]”. Në krye të listës është filmi Psiko [Psycho] i Alfred Hitchcock (1960), i bazuar në romanin me të njëjtin titull të Robert Blochit nga viti 1959. Si Geini, ashtu edhe protagonistin i Psikos, Norman Bates, ishin vetmitarë që vajtonin nënat autoritare dhe, në njëfarë mënyre, kërkonin të shndërroheshin në gra (Bates vishte rrobat e nënës së tij). Bloch tha se historia kishte në qendër “idenë se burri që jeton pranë teje mund të jetë përbindësh, i padukshëm edhe në mikrokozmosin plot thashetheme të një qyteti të vogël”.

Fytyrlëkura [Leatherface], vrasësi kanibal i luajtur nga Gunnar Hansen në filmin Masakra me sharre elektrike në Teksas [The Texas Chain Saw



Massacre] të vitit 1974 - posteri i të cilit thoshte se “Ajo që ndodh është e vërtetë” - ishte gjithashtu i modeluar sipas Geinit. Po ashtu edhe Bufallo Billi në filmin Heshtja e qengjave [The Silence of the Lambs] të vitit 1991 (i bazuar në romanin e Thomas Harrisit nga viti 1988). Ky vrasës serik - i luajtur nga Ted Levine dhe i emëruar sipas një gjahtari amerikan të shekullit XIX që njihej për rrjepjen e bizonëve - vret gra të reja dhe ua heq lëkurën për të bërë një “kostum gruaje”.

Vetë Geini është interpretuar nga Steve Railsback në filmin Në dritën e hënës [In the Light of the Moon, 2000]. Ndërsa në filmin Hiçkoku [Hitchcock] të vitit 2012, ai u luajt nga Michael Wincott (ndërsa regjisor i Hitchcock u luajt nga Anthony Hopkins, i cili kishte sjellë në ekran Hanibal Lekterin në Heshtjen e qengjave). Disa studiues e kanë lidhur “retorikën anti-trans” me mënyrën se si u pasqyrua Gein si veshës i rrobave të grave dhe me personazhet që u frymëzuan nga ai. Një artikull i Washington Post-it në vitin 2022 ka thënë: “Për dekada të tëra, kultura popullore është mbështetur në supozime rreth komunitetit trans, duke nënkuptuar se ka diçka ndryshe, madje shqetësuese dhe të rrezikshme, në lidhje me ta. Origjina e këtij stereotipi, me shumë gjasë, është Ed Gein”.

Kulti i Ed Gein

Edhe përtej filmave, Gein ka qenë prej kohësh një figurë kulti. Krimet e tij janë bërë temë për këngë nga disa grupe hevi-metal, përfshirë këngën Dead

Skin Mask të vitit 1990 nga grupi Slayer. Në vitin 2001 u raportua se ekzistonin 182 faqe interneti që i dedikoheshin atij.

Sot, adhuresit mund të vizitojnë “Përvojën Ed Gein” [The Ed Gein Experience] në Muzeun “Graveface” në Savanë të Xhorxhas. Ajo përfshin rikrijimin të shtëpisë së Geinit si dhe “fotografi të papublikuara më parë nga vendi i krimin dhe e vetmja provë që ka mbetur nga rasti” (një zinxhir çelësash i bërë nga një tufë flokësh njerëzore). Faqja zyrtare e muzeut informon vizitorët e mundshëm: “Nëse ndiheni keq apo të dobët gjatë turit, mund të dilni jashtë ose të lajmëroni ciceronin nëse mendoni se mund alivanoseni”. Një atrakcion turistik që nuk u realizua kurrë ishte vetë ferma e Geinit. Ajo u përfshi nga flakët në vitin 1958, një vit pas arrestimit të tij, mes thashethemeve se ishte shitur te një blerës që donte ta kthente në një muze të “shtëpisë së tmerreve”.

Disa adhures të Geinit janë aq të përkushtuar, saqë duan të zotërojnë një copë nga historia. Hamish McAlpine, producent i Në dritën e hënës, ka thënë: “Ka madje edhe një klub adhuresish të Ed Geinit. Mund të blesh gjësende që kanë të bëjnë me Ed Geinin. Mund të blesh bustin e Ed Geinit, taketuket Ed Gein dhe madje edhe kalendarë të Ed Geinit”.

Në vitin 1958, një shitës në panair pagoi 760 dollarë për makinën “Ford” të vitit 1949 të Geinit. Në vitin 2006, eBay ndaloi një ankand të tokës së vrasësit, ku shitësi kërkonte 250 mijë dollarë. Kompania tha se kjo shkelte politikën e saj që ndalon shitjen e kujtimeve të

lidhura me vrasje. Një biografi e Geinit, me nëntitullin Vrasësi më i çuditshëm i Amerikës [America’s Most Bizarre Murderer] dhe e firmosur nga vetë ai, u shit për 2 500 dollarë në vitin 2017, ndërsa posterat me foton e tij të arrestimit ende shiten në faqet si Etsy.

Rikthimi në ekran me një element britanik

Tani ai po merr sërish kujdesin e Holivudit, këtë herë në një serial tetë-pjesësh në Netflix: Përbindëshi: Rrëfimi për Ed Gein [Monster: The Ed Gein Story]. Bashkëkrijuesit Ryan Murphy dhe Ian Brennan janë marrë dy herë më parë me vrasësit famëkeq amerikanë në serinë Përbindëshi, Rrëfimi i Xhefri Damerit [The Jeffrey Dahmer Story] dhe Rrëfimi për Lajl dhe Erik Menendezin [The Lyle and Erik Menendez Story]. Aktori Charlie Hunnam, i lindur në Njukesëll, luan rolin kryesor. Ai mbështetet nga aktorët britanikë si Tom Hollander (në rolin e regjisorit të Psikos, Alfred Hitchcock), Olivia Williams (si gruaja e Hitchcockut) dhe Lesley Manville (si Worden, viktima e fundit e Geinit).

Laurie Metcalf luan rolin e nënës së tij, ndërsa aktorja amerikane Addison Rae - yll i TikTok-ut që është kthyer në pop-këngëtare - luan adoleshenten që zhduket në mënyrë misterioze. Hunnam, i cili ka ngjashmëri me Geinin, u përzgjedh pasi Murphy pa një foto të tij të bërë nga paparacët. “Thashë me vete: ‘Oh, ai duket i përhumur’. Kishte diçka shumë ‘Edi’ tek ai”, tha Murphy. Për këtë Hunnam u përgjigj: “Duhet të kem pasur një ditë të keqe”. /Telegrafi/

ZAPORIZHIA E PANJOHUR, PSE SULMET RUSE JANË MË TË FRIKSHME TANI?



Sulmet ruse po tregojnë fuqi gjithnjë e më shkatërruese dhe po synojnë makinën e luftës që nxit rezistencën ukrainase. Pavarësisht raporteve nga Kievi, të cilat raportojnë një numër të lartë armësh të kapura, ekziston bindja se dronët dhe raketat e Moskës po shkaktojnë dëme më të konsiderueshme në muajt e fundit. Objektivi kryesor i Kremlinit në gusht dhe shtator ishin fabrikat dhe depot ushtarake të përdorura për të shpërndarë materiale nga jashtë, shpesh të vendosura brenda qendrave tregtare si ajo e shkatërruar dje në periferi të Lvivit. “Financial Times” vuri në dukje se vetëm në gusht, pati të paktën katër bastisje të mëdha kundër kompanive të dronëve. Zakonisht, gjeneralët rusë dërgojnë armët e tyre më të mira kundër këtyre objektivave të mbrojtura rëndë: raketat balistike Iskander-M, raketat hipersonike

Kinzhal dhe raketat kruiz KH-101. Në sulmin e së shtunës në mbrëmje, ata lëshuan 53 prej tyre: një breshëri e tmerrshme që përballet me pengesa gjithnjë e më të dobëta. Përgjigja ukrainase duket se po humbet efektivitetin. Përqindja e armëve balistike si Iskander M që rrëzohen ka rënë ndjeshëm: nga 37 përqind në gusht në gjashtë përqind në shtator. Kjo krizë është për shkak të dy faktorëve. Ngrija e ndihmës falas të SHBA-së, e zëvendësuar nga Trump me një mekanizëm të ri shitjesh për Ukrainën të paguar nga vendet evropiane, ka ngadalësuar dërgesat e Patriot: bateritë më moderne tokë-ajër kanë mbetur pa municione. Në të njëjtën kohë, inxhinierët rusë kanë përsosur sistemet e tyre të sulmit: ata ndryshojnë drejtim gjatë fluturimit, vendosin karrem elektronik për të ngatërruar radarët Patriot ose qëllojnë "topa

zjarri" për të shmangur interceptorët e udhëhequr nga infra të kuqe. Dy baza ajrore të Kievit thuhet gjithashtu se kanë pësuar bombardime të rënda, të kryera me raketa hipersonike Kinzhal, duke ngadalësuar aktivitetin e luftëtarëve ukrainas. Turma prej qindra dronësh shërbejnë për të mbajtur të zënë mbrojtjen kundërajrore, shpesh të detyruar të rrëzojnë "karrema" të paarmatosura dhe dërgohen për të goditur instalimet civile me mbrojtje më pak të fuqishme. Shahed-Geran po synojnë rrjetet e energjisë ukrainase, të cilat janë bërë përsëri një objektiv prioritar: për një javë, sulmet kanë ndodhur në të gjitha qytetet, duke shkaktuar ndërprerje të energjisë elektrike dhe ngrohjes. Kjo ka ndodhur edhe në vitet e mëparshme, por këtë herë sulmet ruse duken edhe më shkatërruese: ato godasin

tubacionet e gazit, termocentralet, nënstacionet e transformatorëve dhe shtyllat e tensionit të lartë. Në disa raste, ata lëshojnë dy breshëri dronësh njëzet deri në tridhjetë minuta larg njëri-tjetrit, duke goditur kështu edhe teknikët e riparimit dhe ekipet e shpëtimit. Përveç privimit të popullsisë dhe industrive nga energjia elektrike, bastisjet e ditëve të fundit janë hakmarrje për fushatën ukrainase të bombave fluturuese që po i prek rafineritë ruse dhe po fillon të ndërpresë furnizimet në stacionet e benzinës në shumë qytete: një goditje e dyfishtë për Kremlinin, e cila dëmton besueshmërinë dhe portofolin e regjimit të Putinit. Edhe sulmet ndaj trenave - e vetmja zonë e lirë që ishte respektuar në dyzet muaj luftë - duket se janë hakmarrje për bombardimet ukrainase të stacioneve të trenave, shinave dhe depove, të kryera për të

parandaluar një ofensivë verore. Megjithatë, duke vazhduar sulmet e tij ndaj energjisë, ka frikë në rritje se Putini mund ta teprojë: Moska po synon gjithashtu centralet bërthamore. Pasi shkëputi centralin e pushtuar të Zaporizhzhisë nga rrjeti ukrainas, brenda një jave ajo ka kryer sulme kundër dy centraleve të tjera bërthamore: padyshim, këto sulme nuk synojnë reaktorët, por linjat e energjisë që transportojnë energjinë. Ekziston një rrezik, të cilin inxhinierët ukrainas deri më tani kanë arritur ta parandalojnë: shembjen e sistemit kombëtar elektrik, duke shkaktuar një ndërprerje totale të energjisë. Ky skenar mund të rrezikojë gjithashtu sigurinë e objekteve radioaktive, të kërcënuara nga bombat që bien vetëm 800 metra larg. Një tjetër makth që po afrohet në kufirin lindor të Evropës.


BE-ja shqyrton një plan të ri për të kufizuar lëvizjet e diplomatëve rusë

Bashkimi Evropian po shqyrton një propozim që potencialisht mund të kufizojë lëvizjet e diplomatëve rusë në të gjithë territorin e bllokut, sipas një dokumenti të shtuar në raundin e fundit të sanksioneve, raporton "Euronews". Plani do të prek anëtarët e misioneve diplomatike dhe konsullore të Rusisë, përfshirë

stafin administrativ dhe teknik, si dhe anëtarët e familjes. Nëse ky propozim miratohet, do të vendoset një detyrim për të dërguarit rusë që të njoftojnë qëllimin e tyre për të udhëtuar ose për të kaluar tranzit nëpër një shtet tjetër anëtar përtej kombit të tyre pritës. Njoftimi duhet të lëshohet “të paktën 24 orë” para mbërritjes,

thotë dokumenti, dhe përcakton mjetet e transportit dhe datën dhe pikën e hyrjes/daljes. Shteti pritës do të ketë më pas mundësinë të lejoj ose jo kalimin. Propozimi u shtua së fundmi nga Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS) në paketën e 19-të të sanksioneve kundër Rusisë, e cila është aktualisht në proces negociatash.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Blendi Baftiu, “Ylli i Javës” në Superligë

PRISHTINË, 7 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ta japë çmimin tradicional “Ylli i Javës”, i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e tetë të këtij edicioni ky çmim i është dhënë futbollistit të FC Prishtina, Blendi Baftiu, i cili ka shënuar golin e vetëm në

ndeshjen kundër rivalit për kreun e tabelës, FC Ballkani, e cila përfundoi me rezultat 1:0. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit.

Pasi ka marrë këtë çmim, Baftiu është shprehur i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës: “Kemi pasur një start shumë të mirë të këtij sezoni si me ekipin ashtu edhe në aspektin personal. Ndeshja e

fundit është pasqyra më e mirë e këtij fillimi pozitiv, sepse ishte derbi kundër Ballkanit dhe një emocion i veçantë, meqë ndeshjen e fituam në minutat e fundit. Më vjen mirë që falë golit tim fituam tri pikë dhe këtë çmim ua dedikoj bashkëlojtarëve të cilët japin kontribut shumë të madh, edhe ‘Plisave’ të cilët nuk mungojnë në asnjë ndeshje dhe janë një shtysë shumë e

madhe për ne. Atmosfera është shumë e mirë në ekip falë rezultateve që kemi arritur. Pretendimi i Prishtinës, si ekipi më i madh në vend, është gjithmonë titulli kampion. Ndihej shumë mirë që jam vlerësuar lojtari më i mirë i javës dhe më vjen mirë që po kontribuoj. Shpresoj ta ruaj këtë formë edhe në vazhdim dhe ta ndihmoj skuadrën në ndeshjet e ardhshme”, ka thënë



Baftiu për faqen zyrtare të FFK-së.

KOSOVA NIS PËRGATITJET PËR NDESHJET E TETORIT

PRISHTINË, 7 TETOR - Kombëtarja e Kosovës e ka nisur fazën përgatitore për dy sfidat e rëndësishme të tetorit në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës 2026 që do të zhvillohen ndaj Sllovenisë më 10 tetor në stadiumin “Fadil Vokrri” dhe ndaj Suedisë më 13 tetor në Goteborg. Dy seancat e para stërvitore janë zhvilluar në atmosferë shumë pozitive, me

përkushtim dhe energji të lartë nga futbollistët, të cilët janë maksimalisht të motivuar për ta dhënë maksimumin në këto duele vendimtare.

Në stërvitje, futbollistët janë ndarë në dy grupe, varësisht nga ngarkesa e ndeshjeve të fundit me klubet e tyre dhe gjendja fizike. Njëri grup ka zhvilluar stërvitje rigjeneruese në palestër në hotel, grupi tjetër ka punuar

me intensitet të lartë në fushën e stadiumit “Fadil Vokrri”.

Krahas kësaj, FFK-ja ka bërë me dije se mesfushori i djathtë i skuadrës polake, Motor Lublin, Florian Haxha, nuk do të jetë pjesë e grumbullimit të Kombëtares së Kosovës për dy ndeshjet e këtij muaji kundër Sllovenisë dhe Suedisë për shkak të gjendjes shëndetësore.



PRESIDENTI I FFK-së FALËNDERON PRESIDENTEN OSMANI PËR NDERIMIN E PRESIDENTIT TË FIFA-s

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka shprehur mirënjohje të thellë ndaj presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, për vendimin që ta dekorojë presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino, gjatë vizitës së tij të dytë zyrtare në Kosovë, që do të ndodhë sot (e mërkurë).

Në letrën drejtuar presidentes Osmani, Ademi ka theksuar se ky akt është një dëshmi e respektit të institucioneve të Republikës së Kosovës ndaj rolit dhe kontributit të z. Infantino për zhvillimin e futbollit të Kosovës dhe afirmimin e shtetit në arenën ndërkombëtare. “Ky akt i lartë



institucional është një dëshmi e respektit që Republika e Kosovës ka për rolin dhe kontributin e z. Infantino si president i FIFA-s, për

zhvillimin e futbollit tonë dhe afirmimin e vendit në arenën ndërkombëtare”, ka theksuar Ademi.

Presidenti i FFK-së ka rikujtuar

faktin se Gianni Infantino, në Kongresin e tij të parë si president i FIFA-s në vitin 2016, pati nderin historik ta shpallë Kosovën anëtare të barabartë të FIFA-s - një moment që shënoi kthesën më të madhe në historinë e futbollit të Kosovës. Sipas Ademit, nën drejtimin e Infantinos, FIFA ka dhënë mbështetje të vazhdueshme për Kosovën përmes programit “FIFA Forward”, duke ndihmuar në ndërtimin e infrastrukturës, zhvillimin e futbollit të rinjve dhe ngritjen profesionale të trajnerëve e zyrtarëve të FFK-së. “Ky vendim i juaji, znj. presidente, forcon edhe më

shumë partneritetin mes institucioneve shtetërore dhe atyre sportive, duke dëshmuar se futbollit është një urë që bashkon njerëzit, gjeneratat dhe kombet”, ka theksuar Ademi.

Në fund të letrës, presidenti Ademi ka falënderuar presidenten Osmani për përkrahjen e vazhdueshme ndaj sportit dhe për vizionin e saj që Kosova të përfaqësohet me dinjitet në çdo fushë, përfshirë edhe atë të futbollit. “Dekorimi i presidentit Infantino është një vlerësim që shkon përtej individit dhe është një nder edhe për gjithë komunitetin e futbollit në Kosovë”, ka përfunduar Ademi.

Lamine Yamal pritet të jetë gati për “El Clasico”

BARCELONË, 7 TETOR - Barcelona dhe tifozët e saj kanë marrë një lajm pozitiv sa i përket rikuperimit të yllit të madh të ekipit, Lamine Yamal. Mes një mori raportimesh të ndryshme rreth gjendjes fizike të Lamine Yamal, gazeta “Marca” ka raportuar se sulmuesi anësori i Barcelonës do të rikuperohet në kohë për “El Clasicon” kundër

Real Madridit në fund të muajit. 18-vjeçari aktualisht është jashtë fushave për shkak të një dëmtimi të përsëritur në ijë të cilin e pësoi pas ndeshjes së Ligës së Kampionëve kundër PSG-së. Ky dëmtim e detyroi ta humbasë ndeshjen e La Ligës kundër Sevillas dhe të tërhiqet nga skuadra kombëtare spanjolle për pushimin ndërkombëtar të këtij

muaji.

Raporti ka theksuar, gjithashtu, se spanjollit mund të shijojë pak kohë loje kundër Gironas menjëherë pas pushimit ndërkombëtar nëse nuk ka ndonjë pengesë në rehabilitimin e tij, që do të thotë se ai do të jetë i disponueshëm për ndeshjet e ardhshme kundër Olympiacos dhe Real Madridit.

Kthimi i Yamal do të jetë një



përmirësim i madh për klubin kataluanas, duke pasur parasysh krizën e lëndimeve dhe rënien e

papritur të formës pas humbjeve të njëpasnjëshme kundër PSG-së dhe Sevillas.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “GMC Prishtina” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811288118 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “GMC Prishtina” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811288118 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “GMC Prishtina” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811288118 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Priam dev” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811503425 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Priam dev” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811503425 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Priam dev” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811503425 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Argjend Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Furrës së bukës.

- “Kalaja”, Sh.P.K me numër Unik identifikues: 810246159 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër: 330008921.

- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.

- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.

- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.

- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.

- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.

- “Fire Protection Agency Rifel Action” LLC. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

